



An EU funded project

EU Trade
Policy Project



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Përmbledhje e Shkurtër mbi Tregtinë

Dimensioni Tregtar i MSA-së me BE-në dhe
Ekonominë e Kosovës

Janar 2015

Mbështetur nga:

Këtë publikim e mbështet projekti i BE-së, “Asistencë Teknike Zhvillimit të Mëtuftjeshëm të Politikës Tregtare të Kosovës”



**EU Trade
Policy Project**



implemented by:



Përgatitur nga:

Arjeta Islami-Muja
Bulinë Mahmudi

Mohim:

Këtë publikim e ka nxjerrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e MTI-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se paraqet pikëpamjet e mbështetësit.

Publikuar nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Rr. Muharrem Fejza
p.n. Lagja e Spitalit
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

HYRJJE

Integrimi i mëtejshëm në ekonominë botërore në mënyrë të pashmangshme do të rezultojë me uljen e barrierave tregtare dhe do të sjellë mundësi të reja për Kosovën. Ai duhet të çojë në lidhje më të mira tregtare në përgjithësi dhe të mbështet rritjen ekonomike. Kosova ka bërë tashmë hapat e parë në integrimin ekonomik përmes anëtarësimit në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA), të themeluar në vitin 2006. Përveç kësaj, Kosova aktualisht përfiton nga Masat Autonome Tregtare të BE-së; kjo korrespondon me trajtimin preferencial i cili mundëson qasje pa taksa doganore në tregun e BE-së. Megjithatë, marrëveshja e fundit tregtare do të zëvendësohet së shpejti me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), një marrëveshje e cila gradualisht do të çojë të dyja palët drejt një zone të tregtisë së lirë bilaterale me heqjen e tarifave të importit për palën kosovare. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) përfaqëson marrëdhënien e parë kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së dhe kjo konsiderohet si pikë kthesë e rëndësishme në procesin e integrimit evropian të Kosovës.

Prandaj, për Kosovën, është më tërheqëse një marrëveshje me bllokun më të madh tregtar në botë. Bizneseve kosovare do t'u jepet qasje tek 500 milionë konsumatorë në 28 shtetet anëtare të BE-së. Bizneset do të përfitojnë nga MSA-ja me uljen e barrierave tregtare dhe krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe transparent tregtar dhe të investimeve; për kompanitë gjithashtu do të jetë më e lehtë dhe më e lirë të eksportojnë prodhimet e tyre në tregjet partnere tregtare. Përveç kësaj, përfitimet nga MSA-ja shkojnë përtej tregtisë, sepse BE-ja lidh MSA-të në këmbim të zotimeve për reformë politike, ekonomike, tregtare në një vend. Në këtë aspekt, Kosova do të bëjë përparime të mëdha në fushat si pronësia intelektuale, prokurimi publik, politika e konkurrencës, dhe tregtia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Megjithatë, ende ka sfida! Dhe disa nga këto sfida janë identifikuar në pjesën e fundit të kësaj përmbledhjeje të shkurtër. Përveç kësaj, kjo përmbledhje përshkruan procesin e negociatave dhe koncesioneve që u janë dhënë produkteve kosovare.

PROCESI I NEGOCIMIT

Pozicioni negociues i Kosovës është bazuar në konsultime me palë të ndryshme të interesit, përfshirë prodhuesit vendor dhe komunitetin e biznesit. Marrëveshja është kryesisht rezultat i analizave, kërkesave dhe informacioneve të cilat Grupi Negociator i ka marrë vazhdimisht nga komuniteti i biznesit dhe përfaqësuesit e tyre përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe diskutimeve të hollësishme në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe me Nën-Grupet për Politikë Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve në Kosovë vazhdimisht janë informuar dhe konsultuar në lidhje me procesin e negociatave, dhe janë marrë parasysh rekomandimet e tyre në lidhje me listën e produkteve që do të mbrohen apo lirohen nga taksat doganore në marrëveshjen

përfundimtare. Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës, roli i Krye-negociatorit i është deleguar Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE), por MTI-ja e ka udhëhequr procesin e negociimit për pjesën tregtare të marrëveshjes. Përveç kësaj, në këtë proces u angazhuan institucionet tjera të Kosovës, përfshirë këtu Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Siç u cekë, procesi i negociatave është mbështetur në analizën e detajuar të ndikimeve të mundshme që marrëveshja do t'i ketë në ekonominë e Kosovës dhe në veçanti në sektorin e jashtëm, në prodhim, punësim dhe të ardhurat qeveritare.¹ Për sa i përket ndikimit në sektorë të veçantë, MTI-ja ka krijuar pozicionin e saj në bazë të një metodologjie të veçantë. Ajo i ka identifikuar produktet e ndjeshme duke marrë parasysh dy treguesit kryesorë të referencës: bilancin tregtar ("a importon apo eksporton Kosova më shumë nga mallrat përkatëse?") dhe tendencën e bilancit tregtar (" a është deficit / suficiti në rritje apo në rënie?"). Në veçanti, rastet ku ka deficit tregtar, por deficit ka qenë në rënie në vitet e fundit, kanë qenë të rëndësishme madhore për ekonominë kosovare, dhe si të tilla të ndjeshme në pjesën e negociatave. Konsiderohej se sektorët që përdorin këto tendenca mund të tregojnë se po zhvillohet një lloj zëvendësimi i importit dhe / ose eksportet janë në rritje. Kjo mund të shpjegohet si një tendencë se industritë kosovare e kanë filluar një proces për ta zënë hapin me konkurrentët global ose të paktën rajonal. Gjithashtu, ka pasur sektorë me deficit të vazhdueshëm tregtar, kështu që ata konsideroheshin të ndjeshëm në periudhën kohore të liberalizimit.

Procesi i Negociatave ka zgjatur për 9 muaj, edhe pse përgatitja kishte filluar një vit më parë (shih Katrorin 1 për datat e rëndësishme të procesit).

KATRORI 1: DATAT E RËNDËSISHME LIDHUR ME NEGOCIATAT PËR MSA

Në renditjen kronologjike, mund të gjeni në vijim ngjarjet që çuan në realizim të MSA-së:

Dhjetor 2012 – Këshilli Evropian (KE) ka konfirmuar progresin dhe mundësinë e hapjes së negociatave për MSA midis Kosovës dhe BE-së;

Prill 2013 – KE ka konfirmuar se Kosova ka plotësuar kriteret afatshkurtra për sundimin e ligjit, administrimin publik, të drejtat e pakicave dhe tregtinë;

Qershor 2013 – duke marrë parasysh plotësimin e kriterëve afatshkurtra, KE-ja ka vlerësuar arritjet dhe ka konfirmuar fillimin e negociatave për MSA;

28 Tetor, 2013 – është mbajtur mbledhja e parë midis Qeverisë së Kosovës dhe KE-së për të negociuar MSA-në. Mbledhja e dytë u mbajt në 27 nëntor, 2013;

2 Maj, 2014 – është mbajtur mbledhja e tretë dhe e fundit për negociatat e MSA;

25 Korrik, 2014 – përfunduan negociatat për MSA midis Kosovës dhe BE-së;

Hapi i ardhshëm është miratimi i MSA-së nga Këshilli i BE-së dhe nënshkrimi i marrëveshjes midis palëve.

¹ Analiza e ndikimit dhe metodologjia janë mbështetur në "Studim mbi Vlerësimin e Ndikimit (SIA)", i përfunduar në fillim të vitit 2013.

KONCESIONET E DAKORDUARA

Marrëveshja me Bashkimin Evropian (BE) është një asimetrike, në favor të Kosovës; kështu, të gjitha produktet e Kosovës janë liruar menjëherë nga taksat doganore, me përjashtim të mishit të viçit, sheqerit dhe verës, të cilat janë objekt i kufizimeve sasiore. Nga ana tjetër, Kosova do të mënjërohet graduale do t'i heq taksat doganore sipas periudhave të caktuara kalimtare derisa ekonomia e vendit ta zë hapin me konkurrentët e rinj që vijnë nga tregu i BE-së. Kosova ka lidhur marrëveshje për 99,7% të produkteve kosovare, kështu që 0,3% e produkteve nuk janë pjesë e Marrëveshjes së MSA-së Kosovë-BE.

Në veçanti, për shkak të shkallës së lartë të ndjeshmërisë, nevojiten koncesione më të mëdha për produktet bujqësore. Si rezultat, 11 linja tarifore janë përjashtuar nga negociatat e MSA-së, ndërkohë që janë negociuar 1,745 linja tarifore. Janë 1204 produkte (68,56%), që do të liberalizohen menjëherë nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes; në këtë grup janë 160 produkte bujqësore të cilat lirohen nga detyrimet doganore.² The. Pjesa e mbetur prej 541 produkteve bujqësore do të liberalizohen brenda 5, 7, dhe 10 vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Për peshkun dhe produkte të peshkut, Kosova ka rënë dakord për liberalizim të menjëhershëm të 490 produkte (99,59%). Vetëm 2 produkte do të liberalizohen brenda 5, respektivisht 7 viteve.

Kosova i konsideron Produktet e Përpunuara Bujqësore (PPB) me origjinë nga BE-ja si produkte të ndjeshme; si rezultat, 135 produkte (42,72%) nga 316 PPB-të liberalizohen menjëherë. Nga MSA-ja përjashtohen 3 linja tarifore, ndërsa 178 linja tarifore do të liberalizohen brenda 5, 7 dhe 10 vjet pasi Marrëveshja të jetë në fuqi.

Sa i përket produkteve industriale, Kosova ka rënë dakord për koncesionet në vijim: 4,763 (69,84%) nga 6819 produkte liberalizohen menjëherë, ndërsa 1,740 produkte lirohen nga detyrimet doganore. 2056 produktet e mbetura industriale do të liberalizohen brenda 5 dhe 7 vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

NDIKIMI NË EKONOMI

Hapja e tregut luan një rol të rëndësishëm në ekonomi në shumë aspekte. Është dëshmuar se tregtia ndërkombëtare është një nga përbërësit më të rëndësishëm të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, duke rezultuar në të ardhura më të larta dhe nivelet e mirëqenies për shoqëritë.

Dihet se procesi i anëtarësimit në BE ka efekte të rëndësishme pozitive. Pavarësisht ndikimit fiskal të kësaj marrëveshjeje në Kosovë, humbja e të ardhurave të qeverisë, e vlerësuar në

² Ligji nr. 04/L-163 Ligji për Mallrat e Liruara nga Detyrimi Doganor dhe Mallrat me Normë Zero të Detyrimit Doganor. Ky ligj përcakton mallrat të cilat lirohen nga detyrimi doganor dhe të cilat mund të lëshohen për qarkullim të lirë pa detyrim doganor zero për shkak të natyrës së mallrave dhe për shkak të përdorimit të tyre të veçantë.

rreth 25 milionë euro, hap tregun e BE-së për bizneset e Kosovës; siguron qasje në teknologji, ekspertizë, etj.; zgjeron mundësitë e tregtisë dhe investimeve; sjell efekte pozitive të përhapjes tek prodhuesit e brendshëm, sepse krijon konkurrencë të re, nevojën për inovacione dhe për të qenë në hap me teknologjitë e reja. Përveç kësaj, zgjerimi i tregut rrit kredibilitetin e vendit sa i përket rregullave dhe rregulloreve, si dhe kornizës institucionale. Ndikimi i hapjes së tregut në tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), është i një rëndësie të madhe për ekonominë në zhvillim dhe tranzicion si Kosova. Vlen të theksohet se nga perspektiva e Kosovës, liberalizimi i tregtisë ofron mundësinë e lidhjes së prodhuesve vendas me zinxhirët global të vlerës. Ka gjasa që këto efekte të nxitin rritjen, rritjen e punësimit dhe zbutjen e varfërisë. Krijimi i vendeve të punës nënkupton të hyra më të mëdha dhe, si rezultat, standard më të mirë jetese - ose në përgjithësi mirëqenie e përmirësuar.

Mirëpo, përvojat tjera na tregojnë se përfitimet nga liberalizimi i tregtisë kushtëzohen nga faktorët e ofertës. Ky është edhe rasti me Kosovën. Edhe pse baza e prodhimit në Kosovë është e pakët, me angazhimin e prodhuesve vendas dhe mundësive të reja që kjo hapje e tregtisë pritet të sjellë, kjo bazë e prodhimit përfundimisht do të zgjerohet. Megjithatë, nëse performanca institucionale nuk përmirësohet më tej në mënyrë që të krijojë kushte edhe më të favorshme për bizneset dhe investimet e reja, liberalizimi i tregtisë mund të mos jep plotësisht rezultatet e dëshiruara, të cilat ndikojnë si në përfitimet e konsumatorëve, ashtu edhe të prodhuesve. Për të shfaqur rezultate të rritjes së fuqishme, kjo duhet të shoqërohet me politika të përshtatshme siç janë arsimimi më i mirë dhe nivele më të larta të aftësive, infrastruktura më e mirë, stabiliteti financiar dhe makroekonomik, etj.

Përveç gjërave të lartpërmendura, një tjetër gjë shumë e rëndësishme të cilën Kosova do të mund ta përfitoj nga BE-ja në përgjithësi, dhe nga MSA-ja në veçanti, është ndihma financiare dhe teknike. Ky lloj i mbështetjes pritet të luajë rol të rëndësishëm në nxitjen e zbatimit të reformave që kanë të bëjnë me arsim, trajnim, shërbim bankar dhe financa, promovim të NVM-ve dhe stabilizim makro-ekonomik. Përveç kësaj, një pjesë e ndihmës financiare të BE-së sigurohet në formë të granteve që do t'i shpërndahen sektorit industrial dhe bujqësor për të përmirësuar ekonominë e Kosovës.

Në përgjithësi, duket e arsyeshme të konkludohet se MSA-ja do t'i sjell dobi ekonomisë dhe bizneseve të Kosovës, duke siguruar mundësi tjera për të tejkaluar pengesat aktuale nga ana e ofertës. të cilat konsiderohet se janë problem kryesor në ekonominë e Kosovës. Më e rëndësishmja, përparësitë e Marrëveshjes mbi Tregtinë e Lirë në kuadër të MSA-së mund të përdoret si mënyrë për të rritur nivelin e produktivitetit, faktor tjetër i rëndësishëm, i cili përcakton konkurrencën ndërkombëtare të bizneseve në Kosovë.